



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 2 prill 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratuan procesverbalet e mbledhjeve të Bordit: nr. 11, datë 02.03.2026; nr. 12, datë 10.03.2026; nr. 13, datë 12.03.2026; nr. 14, datë 19.03.2026 dhe nr. 15, datë 27.03.2026.

U miratua kërkesa e shoqërisë “DION Energji” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U vendos heqja e pezullimit të vendosur me vendimin e Bordit nr. 340, datë 23.12.2025, si dhe zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 1”.

U vendos heqja e pezullimit të vendosur me vendimin e Bordit nr. 16, datë 26.01.2026, si dhe zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024, i ndryshuar.

U vendos zgjatja deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes për kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e asetëve të saj, si dhe detyrimi për depozitimin e sqarimeve dhe dokumentacionit përkatës nga shoqëria dhe banka.

U miratua dhënia e autorizimit për shoqërinë “SUN BEAT SYSTEM” sh.p.k. për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

U miratua kërkesa e shoqërisë “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” sh.p.k., Dega në Tiranë, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.

Në kuadër të çështjeve të tjera, u shqyrtua kërkesa e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. për reflektimin në Aneksin A të licencës të kapacitetit të instaluar të ndryshuar për HEC “Moglicë” dhe HEC “Banjë”.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.